



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:086208

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589250

C.nr.969/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari G.A, me bashkëpunëtorin profesionale B.S, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. K për D. dhe F. me E. E. Sh.A. (K...) me seli në Prishtinë, Bulevardi “B. K.”, nr.5, kundër të paditurit D.H nga Gj. rr. “M. G”, nr.10 me objekt kontesti kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 942.80 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 17.04.2024, ndërsa, më datë 18.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.A. (K..) me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri D. H nga Gj, që t’ia kompensojë paditëses dëmin e shkaktuar material në shumë prej 942.80 € (nëntëqind e dyzet e dy euro e tetëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë 03.04.2023 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. Obligohet i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia kompensojë paditëses, shumë prej 20.00 Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm..

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja K. K për D. dhe F. me E. E. Sh.A. (K...) me seli në Prishtinë, me datë 07.04.2023, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurit D. H nga Gj, për kompensimin e dëmit material, me vlerë të kontestit prej 942.80 € .

Paditësja, në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për dëmin e shkaktuar material nga i padituri D. H, në shumë prej 942.80 euro, pasi që i padituri, me qëllim që vetes t’i sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë lidhje direkte në rrjetin e tensionit të ulët, duke e anashkaluar

njehsorin elektrik dhe duke shpenzuar energjinë elektrike pa matje. Theksoi se i padituri është njoftuar me kohë për dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe nuk e ka kompensuar dhe se as nuk ka dhënë sinjale, se do ta përmbushë në procedurë të rregullt. Sipas paditëses, përgjegjësia e të paditurit është vërtetuar edhe ne bazë të transaksioneve të konsumatorëve dhe aktgjykimeve penale të dorëzuara nëpërmjet padisë, se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses dhe deri më tani i padituri nuk e ka përmbushur dëmin të cekur si në padi. Sqaroi se për shkak se transaksioni i konsumatorit me shifrën DGL 1898 ku nuk është e regjistruar në emër të D. H, mirëpo, në rastin konkret, edhe gjatë seancave në procedurën penale i njëjti e ka pranuar se banesa është e tij, mirëpo për shkak të borxhit që ka ndaj paditëses nuk ka mundur ta bartë në emrin e tij, mirëpo, kjo është vërtetuar në bazë të dy dokumenteve të paraqitura gjykatës, siq janë aktgjykimet penale të formës së prerë, ku i padituri është shpallur fajtor.

Si prova i propozoi gjykatës që të administrohen: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gj.-Divizioni penal me shenjen P.nr. 693/20 i datës 24.08.2021; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gj.-Divizioni penal me shenjen P.nr.853/20 i datës 30.09.2021; Transaksioni i konsumatorit me numrin DGL 1898.

Nga këto arsye, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën që t'ia paguajë dëmin material në shumën prej 942.80 Euro, me kamatë ligjore nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 20 Euro.

Gjendja faktike në bazë të provave të administruara

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se e padituri ishte konsumtarore tek paditësja dhe se paditëses i është shkaktuar dëm material si rrjedhojë e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike nga i padituri, sepse kjo vërtetohet nga aktgjykimi penal, ku i padituri si i akuzuar e ka pranuar fajsinë për veprën penale vjedhje e shërbimeve, por kontestuese ishte lartësia e dëmit dhe vlera që duhet kompensuar paditëses si rezultat i dëmit.

Gjykata, për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gj.-Divizioni penal me shenjen P.nr. 693/20 i datës 24.08.2021; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Divizioni penal me shenjen P.nr.853/20 i datës 30.09.2021; transaksioni i konsumatorit me numrin DGL 1898.

Nga leximi i Aktgjykimit penal P.nr. 693/20 i datës 24.08.2021, u vërtetua se i padituri D. /H/ H, është shpallur fajtor për shkak të vjedhjes së shërbimeve komunale, sepse me datë 16.08.2019, e ka shfrytëzuar në vazhdimësi energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar. I njëjti e ka pranuar fajsinë dhe ndaj tij është shqiptuar denimi me kusht (denim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda një viti nuk kryen vepër penale tjetër).

Nga leximi i aktgjykimit penal P.nr.853/20 i datës 30.09.2021, u vërtetua se i padituri D. H/H , është shpallur fajtor për shkak të vjedhjes së shërbimeve komunale, sepse me datë 12.05.2020, e ka shfrytëzuar në vazhdimësi energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar. I njëjti e ka pranuar fajsinë dhe ndaj tij është shqiptuar denimi me kusht (denim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda një viti nuk kryen vepër penale tjetër).

Nga leximi i transaksionit të konsumatorit, me nr. DGL 1898, i datës 27.03.2023, gjykata vërtetoi faktin se konsumtatori është me adresë në Rr.”S.” dhe se evidentohet në emër të personit të quajtur “H. A”, shuma e borgjit, që e ka i padituri ndaj të paditurës është në lartësi prej 2,028.40€.

Meqenëse, çështja e legjitimitetit është prezumin i natyrës materialo-juridike, paraprakisht, gjykata në këtë çështje, shqyrtoi legjitimitetin e palëve në procedurë, konform nenit 76 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), “*gjykata gjatë tërë procedurës duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale*”. Gjykata gjeti se palët janë të legjitimuara në këtë procedurë, për faktin se mes tyre ka ekzistuar raport juridik civil, ku pala paditëse ka qenë në cilësinë e ofruesit të shërbimeve, ndërsa, në cilësinë e shfrytëzuesit të shërbimeve ka qenë i padituri, fakt ky që vërtetohet nga deklarimi i të paditurit në procedurë penale, i cili ka pranuar fajësinë mbi dëmin e shkaktuar paditëse, ani pse i njëjti në trasnaksionin e konsumatorit nuk evidentohet si shfrytëzuesi i tij, andaj si rezultat i kësaj ka lindur edhe e drejta e paditëses për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Gjykata vërtetoi se e padituri D. H i ka shkaktuar dëm material paditëses, pasi që ky fakt vërtetohet nga provat: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gj.-Divizioni penal me shenjen P.nr. 693/20 i datës 24.08.2021; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Divizioni penal me shenjen P.nr.853/20 i datës 30.09.2021, me të cilët e padituri është shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale, ndërsa lidhur me lartësinë e dëmit të shkaktuar, vërtetimin e saj, gjykata e bëri nga transaksioni i konsumatorit me nr. DGL 1898, për periudhat, për të cilat e padituri ishte shpallur fajtor me dy aktgjykimet penale, ku me veprimet e tij ka dëmtuar paditësen në shumën prej 942.80€ (kalkulimi i rikthimit të humbjeve sipas faturës DGL 1898, andaj, vlerësoi se paditësja ka argumentuar përgjegjësinë e të paditurit në shkaktimin e këtij dëmi përmes aktgjykimeve penale dhe vlerën e dëmit të shkaktuar përmes kalkulimit të rikthimit të humbjeve.

Baza ligjore dhe vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet të aprovohet padia e paditëses si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

I padituri i ka shkaktuar dëm paditëses dhe kjo rrethanë u vërtetua me prova në procedurë. Neni 137 parasheh se: “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm)*”, andaj,

gjykata duke u bazuar në nenin 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin është përcaktuar se: *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, ku përmes interpretimit të kësaj dispozite dhe në ndërlidhje me Nenin 245 të LMD-së parasheh se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë.”* Gjykata vlerëson se pala e paditur është e obliguar t’ia kompensojë dëmin palës së dëmtuar me vepër penale në këtë rast në shumën 942.80 Euro.

Gjykata, shumën 942.80 Euro, e ka obliguar të paditurin t’ia kompensojë paditëses, duke u bazuar në nenin 140 të LMD-së, në të cili parashihet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*, andaj, po t’i referohemi kësaj dispozite lidhur me ekzistimin e fajësisë atëherë ky fakt vërtetohet se tek e padituri ekziston fajësia sipas dy aktgjykimeve penale të formës së prerë të Gjykatës Themelore Gj.: P.nr. 693/20 i datës 24.08.2021 dhe P.nr.853/20 i datës 30.09.2021, ku i padituri është shpallur fajtor për veprën penale *“Vjedhje e shërbimeve komunale”* nga neni 314 i KPRK-së, ndërsa, paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Poashtu, se palës paditëse i takon e drejta për kompensimin e dëmit, kjo kërkesë bazohet dhe në dispozitat e nenit 169 paragrafët 1 dhe 4 të LMD-së, ku parashihet se se: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”. “Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.”*

Gjykata në procedurë civile në këtë rast është e lidhur dhe e obliguar me aktgjykimet penale, me të cilët e padituri është shpallur fajtor, kjo konform dispozitës së nenit 14 të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”* Prandaj, pasi që e padituri është shpallur fajtor me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës në procedurë penale dhe është konstatuar dëmi i shkaktuar paditëses nga e padituri, atëherë gjykata e obligoi atë që t’ia paguajë dëmin paditëses në shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës, vendosi si nën pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 452 par. 1 të LPK-së.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenet 136, 137, 140, 169, dhe 245 të LMD-së, nenit 14 të LPK-së dhe konform nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.969/2024, me datë 18.04.2024

Gjyqtari,

Numri i lëndës: 2023:086208
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05589250

G. A

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.